

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN, "PËR PRODUKTET PLEHRUES"

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është garantimi i shëndetit të njerëzve dhe kafshëve si dhe mbrojtja e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehrues; rritja e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elementë ushqyes si dhe përmirësimi i cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës.

Objektivi që synohet të arrihet është përcaktimi i rregullave për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, publicitetin, inspektimin e veprimtarive, që lidhen me produktet plehrues si dhe organizimin dhe funksionimin e strukturave përkatëse.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe veçanërisht me konsolidimin dhe sigurinë juridike në fushën e sigurisë ushqimore.

Ky projektligj nuk është parashikuar në vendimin nr.37, datë 24.1.2018, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Akteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018", por miratimi i tij është shumë i rëndësishëm.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Njohja dhe evidentimi i çdo hallke të zinxhirit ushqimor është i një rëndësie të veçantë për garantimin e shëndetit publik dhe mbrojtjen e interesit të konsumatorit në përgjithësi.

Produktet plehruës janë grupi më i rëndësishëm i inputeve bujqësore dhe me një shumëllojshmëri formulimesh dhe përmbajtje të lëndëve ushqyese, me veprim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bimëve dhe të prodhimtarisë e të cilësisë së prodhimit, pa përjashtuar edhe ndikimin po të drejtpërdrejtë në sigurinë ushqimore.

Ky projektligj prek mbi 70 % e përmbajtjes së ligjit nr. 10390, datë 3.3.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë" dhe, për këtë arsye paraqitet si projektligj i ri. Përparësitë me ligjin ekzistues po i renditim si vijon:

- Ky projektligj, në gjithë përmbajtjen e tij, është më i thjeshtë po aq sa i saktë në kërkesa dhe procedurë.
- Termat e përdorura përfaqësojnë gjithë përmbajtjen e ligjit dhe janë më të qartë në interpretim dhe zbatueshmëri.
- Që në titullin e ligjit është pasqyruar ndryshimi, që përfaqëson dhe pasqyron ndryshimin në vetë përmbajtjen e ligjit. Sipas përkufizimit, termi "Produkt plehruës" është lënda, përzierja, mikro-organizmi ose çdo material tjetër, që përdoret vetëm ose i përzier me material tjetër, te bimët ose rizoferën e tyre me qëllim sigurimin me elementë ushqyës ose përmirësimin e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve. Klasifikon produktet plehërues në 11 grupe të rëndësishme: produktet plehruës inorganik ose mineral; produktet plehruës organik; produktet plehruës organo-mineral; produktet plehruës bazuar në elementë ushqyës dytësorë; produktet plehruës bazuar në mikroelementë; produktet plehruës me veprim specifik; produktet plehruës të veçantë; korrektuesit (korrigjuesit); substratet e kultivimit (rritjes); përmirësuesit e tokës; materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehruës organo-mineral.
- Përcakton strukturat përkatëse dhe detyrat e sejcilit prej tyre me mirëfunktionimin e kontrollit dhe monitorimit të plehrave që nga miratimi për licensim të prodhimit, regjistrimi, tregtimi, si dhe në kryerjen e inspektimeve dhe të analizimit të produkteve plehruës.
- Kënaq kërkesat aktuale të bujqësisë sonë lidhur me trendin gjithmonë në rritje për sasinë, llojshmërinë dhe cilësinë e produkteve plehruës, sidomos në zgjidhjen e shumë problemeve të lindura vitet e fundit për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e produkteve plehruës në Shqipëri.

- Përcakton vetëm tregtimin e produkteve plehruës të regjistruar. Kjo ndikon në forcimin e gjurmueshmërisë së produkteve plehruës si dhe mënjanon parregullsitë dhe shmangiet e mundshme ligjore në importimin, tregtimin dhe përdorimin e tyre.
- Parashikon procedura më të thjeshtuara regjistrimi, me dokumentacion më të qartë dhe me afate të shkurtuara.
- Janë saktësuar qartë afatet e vlefshmërisë së regjistrimit të produkteve plehruës si dhe përmbajtja e dokumentave të regjistrimit (certifikata dhe etiketa).
- Përcaktohet gjurmueshmëria në të gjitha nivelet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehruës. Detyron prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve plehruës që të krijojnë sisteme për mbajtjen e të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo cast të produktit plehruës si dhe çdo personi fizik apo juridik, që i ka furnizuar apo është furnizuar me produkte plehruës. Për qëllimet e gjurmueshmërisë së produkteve plehruës, nga drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri, mbahen "Regjistri i produkteve plehruës", i cili përmban një seksion të veçantë për ata që lejohen në bujqësinë organike, si dhe "Regjistri i prodhuesve të produkteve plehruës".
- Janë përcaktuar më thjeshtë dhe më saktë modifikimi i dokumentit të regjistrimit, çregjistrimi dhe rinovimi i regjistrimit (riregjistrimi) i produkteve plehruës.
- Ndalon prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e: produkteve plehruëse të paregjistruara; produkteve plehruës me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose një rrezik për mjedisin ose për sigurinë publike; produkteve plehruës të falsifikuar; produkteve plehruës të tjetërsuar; produkteve plehruës me përmbajtje të padeklaruar.
- Rëndësi të veçantë i kushton publikimit, ku Ministria informon në faqen e saj zyrtare, median e shkruar ose elektronike, prodhuesit, importuesit, tregtuesit, listën e produkteve plehruëse që lejohet të qarkullojnë në vendin tonë si dhe veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i produkteve plehruës.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk për afron legjislacionin e BE-së, por ka si referencë legjislacionin e disa vendeve të BE-së, sidomos të Italisë dhe Spanjës.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj ka 9 krerë me 34 nene.

**Në kreun I** “Qëllimi, objekti, fusha e zbatimit dhe përkufizime. Klasifikimi produkteve plehruës”, përcaktohet se ky ligj ka për qëllim garantimin e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve si dhe mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehruës; rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elementë ushqyes; përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës. Objekti është përcaktimi i rregullave për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, publicitetin, inspektimin e veprimtarive, që lidhen me produktet plehruës si dhe organizimin dhe funksionimin e strukturave përkatëse. Ky ligj zbatohet për produktet plehruës, që regjistrohen, prodhohen tregtohen për t’u përdorur në Republikën e Shqipërisë si dhe për personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji si dhe të legjislacionit për lejet dhe licencat. Tek neni jepen përkufizimet e termave që trajtohen në projektligj sidomos të termit “produkt plehërues” që i jep një kuptim më të gjerë, më të plotë dhe më domethënës: “Produkt plehruës” është lënda, përzierja, mikro-organizmi ose çdo material tjetër, që përdoret vetëm ose i përzier me material tjetër, te bimët ose rizoferën e tyre me qëllim sigurimin me elementë ushqyes ose përmirësimin e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve. Neni 5 i klasifikon produktet plehërues në 11 grupe të

rëndësishmë: produktet plehruës inorganik ose mineral; produktet plehruës organik; produktet plehruës organo-mineral; produktet plehruës bazuar në elementë ushqyes dytësorë; produktet plehruës bazuar në mikroelementë; produktet plehruës me veprim specifik; produktet plehruës të veçantë; korrektuesit (korrigjuesit); substratet e kultivimit (rritjes); përmirësuesit e tokës; materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehruës organo-mineral.

**Në kreun II** “Prodhimi i produkteve plehruës”, përcaktohen kriteret dhe rregullat për prodhimin e produkteve plehruës nga lënda e parë deri në produktin përfundimtar, afatet e miratimit.

**Në kreun III** “Regjistrimi i produkteve plehruës”, përcaktohen kriteret dhe rregullat për regjistrimin e produkteve plehruës, të dhënat e dosjes dhe procedura për regjistrimin e produkteve plehruës, përgatitja e listës së produkteve plehruës dhe listës së prodhuesve të produkteve plehruës dhe publikimin në faqen zyrtare të ministrisë sa herë që pësojnë ndryshime, tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehruës, përmbajtja e dokumentit të regjistrimit të produktit plehruës (certifikatë e regjistrimit dhe etiketë), kushtet në të cilat kryhet reregjistrimi i produkteve plehruës, çregjistrimi dhe modifikimi i dokumentave të regjistrimit të produkteve plehruës, të regjistruar. Reregjistrimi i produktit plehruës bëhet direkt nga komisioni, kur kjo kërkohet nga aplikanti para përfundimit të afatit të regjistrimit, çregjistrimi i produktit plehruës kryhet nga kryetari i komisionit, modifikimi i dokumentit të regjistrimit të produktit plehruës kryhet nga kryetari i komisionit ose direkt nga komisionit, sipas rasteve të përcaktuara.

**Në kreun IV** “Tregtimi, transporti, ruajtja, etiketimi dhe përdorimi i produkteve plehruës”, përcaktohen kriteret dhe rregullat për tregtimin, transportin, ruajtjen, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehruës. Lejohet vetëm importimi dhe tregtimi i produkteve plehruës të regjistruar. Në njësitë e tregtimit të produkteve plehruës ndalohej: mbajtja dhe tregtimi i produkteve plehruës në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji; asgjësimi i ambalazheve dhe i produkteve plehruës të skaduara apo të dëmtuara; mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz dhe kafshë; riambalazhimi i produkteve plehruës, pasi janë vendosur në treg; kushtet e mjeteve për transportin e produkteve plehruës; kushtet në magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë, që duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të

produkteve plehrues, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketë; kriteret e mbalazhimit dhe etiketimit të produkteve plehrues. Rëndësi e veçantë i kushtohet përdorimit të produkteve plehrues, ku përcaktohet se: lejohet vetëm përdorimi i produkteve plehrues të regjistruar; produktet plehrues përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në etiketë si dhe përdorimi i produkteve plehrues të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve, konsumatorëve, kafshëve dhe mjedisit.

**Në kreun V** “Kufijtë e tolerancës. Produktet plehrues të nitratis të amonit, me përmbajtje të lartë azoti”, përcaktohet se përmbajtja e deklaruar në produktet plehrues duhet të jetë në përputhje me kufijtë e tolerancës. Produktet plehrues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, janë produkte me bazë nitrat amoni, të prodhuara për t'u përdorur si produkte plehrues dhe që përmbajnë mbi 28 për qind në masë të azotit në raport me nitratin e amonit. Produktet plehrues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, duhet të jenë të disponueshëm përpara përdorimit përfundimtar, vetëm në formë të paketuar.

**Në kreun VI** “Organizimi dhe funksionimi i strukturave”, përcaktohen strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe detyrat për secilën strukturë. Vend shumë të rëndësishëm zënë laboratorët e kontrollit cilësor të produkteve plehrues. Laboratori kombëtar i referencës është public, ndërsa laboratorët e miratuar të kontrollit mund të jenë publikë ose privatë.

**Në kreun VII** “Analizimi, gjurmueshmëria dhe publiciteti i produkteve plehrues”, përcaktohet se: analizat laboratorike të mostrave të produkteve plehrues bëhen në laboratorin e referencës dhe në laboratorët e miratuar të kontrollit, sipas metodave të përcaktuara. Rezultati përfundimtar i analizave jepet brenda një periudhe kohe prej 10 ditësh pune nga çasti i dorëzimit të mostrës për analizim; gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehrues. Prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve plehrues krijojnë sisteme për mbajtjen e të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo cast të produktit plehrues si dhe çdo personi fizik apo juridik, që i ka furnizuar apo është furnizuar me produkte plehrues. Për qëllimet e gjurmueshmërisë së produkteve plehrues, nga drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri, mbahen "Regjistri i produkteve plehrues", i cili përmban një seksion të veçantë për ata që lejohen në bujqësinë organike, si dhe "Regjistri

i prodhuesve të produkteve plehrues"; ndalohet prodhimi, importi, vendosja në treg dhe përdorimi i: produkteve plehruese të paregjistruara; produkteve plehrues me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose një rrezik për mjedisin ose për sigurinë publike; produkteve plehrues të falsifikuar; produkteve plehrues të tjetërsuar; produkteve plehrues me përmbajtje të padeklaruar. Pesha neto e produkteve plehrues të ambalazhuar për tregtim duhet të jetë e njëjtë me atë të shkruar në etiketë. Toleranca e lejueshme është deri në 1 %. Ministria informon në faqen e saj zyrtare, median e shkruar ose elektronike, prodhuesit, importuesit, tergtusit, listën e produkteve plehruese që lejohet të qarkullojnë në vendin tonë si dhe veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i produkteve plehrues.

**Në kreun VIII “Kundërvajtje administrative”,** përcaktohen kundërvajtjet administrative, ndëshkimet përkatëse si dhe të drejtën e dhënies së masës administrative. Të gjitha të ardhurat nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

**Në kreun IX “Dispozita të fundit dhe kalimtare”,** detyron nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, me afate përkatëse. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 10390, datë 3.3.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", për aq sa përputhen me ligjin në fuqi. Shfuqizon ligjin nr. 10390, datë 3.3.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë". Ngarkon Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij ligji.

## **VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Bujqësisë edhe Zhvillimit Rural.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është përgatitur nga Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Zbatimi i këtij projektligji nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**Niko Peleshi**